




Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe të vajzave

Raporti Vjetor 2007



Prishtinë, Kosovë

Misioni Ynë

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave anembanë Kosovës, pa dallim për sa i përket mendimit politik, fesë, moshës, nivelit të arsimimit, orientimit seksual dhe aftësisë. RrGGK përmbush misionin e vet përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, avokimit dhe hulumtimit.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës Raporti Vjetor 2007

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

+381 (0) 38 245 850

info@womensnetwork.org

Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8

Prishtinë, Kosovë

www.womensnetwork.org

Përmbajtja

Fjala e Drejtoreshës Ekzekutive	2
Fjala e Kryetares së Bordit	4
Objektivat e RrGGK-së	5
Rreth këtij Raporti	6
Programet dhe Aktivitetet 2007	
Ngritja e Kapaciteteve të RrGGK-së & Shërbimet për Anëtarët tona	7
Rrjetëzimi Ndërkombëtar & Këmbimi i Informatave	10
Ngritja e Nivelit të Pjesëmarrjes së Grave në Politikë & Vendimmarrje	13
Luftimi i Trafikimit & Dhunës ndaj Grave	23
Përmirësimi i Shëndetit të Grave	25
Bordi i Drejtorëve i RrGGK-së	27
Anëtarët e Stafit të RrGGK-së	28
Raporti Financiar 2007 i RrGGK-së	30
Përkrahësit Financiar të RrGGK-së	31
Programet e Ardhshme të RrGGK-së	32
Organizatat Anëtare të RrGGK-së	34

Raporti Vjetor 2007 i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës

© 2008 Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8, Prishtinë, Kosovë
Lejohet e drejta për ribotim.

Fjala e Drejtoreshës Ekzekutive

Të nderuara anëtare të RrGGK-së, partnerë dhe miq,

Që nga viti 1999, sa herë që arrija në ndonjë aeroport evropian, zhvillohej i njëjti skenar: unë ia dorëzoja “dokumentin e udhëtimit të UNMIK-ut”personit zyrtar për kontrollim të pasaportave. Ajo apo ai e shikonte e/i hutuar dhe pyeste “Çfarë dokumenti është ky? Nga cili vend vini?” dhe fillonte të shtypte në kompjuter.

Unë, si të gjithë bashkëqytetarët e mi, prisnim disa minuta derisa personi zyrtar vazhdonte të hulumtonte, në përpjekje për ta verifikuar ekzistimin e një dokumenti të tillë. Më në fund personi zyrtar thërriste me zë të lartë, “Aha! E gjeta! Ju jeni kategoria ‘XXX!’”

Nëse jeni nga ndonjë shtet i themeluar kaherë, dokumentet e të cilit njihen në gjithë botën, nuk mund ta kuptoni ndjenjën e të qenit pa identitet; përpjekjet për t’u spjeguar njerëzve vendin prej nga vini; pritja me javë për të marrur vizë për udhëtime zyrtare dhe akuzat e nëpunësve të ambasadës se po përpiqesh të emigrosh edhe në rastet kur ke ftesë me shkrim nga vendimarrësit e nivelit të lartë të shtetit ku ju shkoni, etiketimi nga organizatat ndërkombëtare me shifrën “xxxxxxx” në mënyrë që te merrni ndihma ngaqë jeni përzënë me forcë nga shtëpia juaj; të ardhur nga vendi i quajtur XXX.

Më 17 shkurt 2008 qytetarët e Kosovës festuan lindjen e shtetit të ri. Shumica prej nesh me lot gezimi vallëzonim dhe këndonim në rrugë për tri ditë me radhë. Më në fund ne kemi emër: Kosova! Më në fund ne kemi identitet. Më në fund ne jemi një hap më afër kah ardhmëria paqësore për vendin tonë dhe regjionin.

Gratë kontribuan shumë për këtë ditë. Gjatë viteve të '90-ta ato rrezikuan jetën e tyre duke udhëtuar përtej kufijve që të avokojnë për pavarësinë e Kosovës. Gratë kanë spjeguar konfliktin në nivelet e larta vendimarrëse ndërkombëtare, jo me gjuhë politike por në atë mënyrë që të kuptojnë se cka nënkuptonte për njerëzit jeta në një shtet represiv.

Pas luftës (1999), gratë vazhduan të avokojnë te vendimarrësit për pavarësinë e Kosovës dhe ndihmuan rreth

ligjvënies, Kushtetutës dhe sistemit të ri shtetëror në Kosovë. Anëtarët e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK-së) kanë kontribuar në ndërtimin e rrjetit të fuqishëm avokues që artikulon brengat e grave te vendimarrësit vendor dhe ndërkombëtar.

Edhe pse neve na është mohuar ulësja në tryezën e negociatave lidhur me statusin final të Kosovës, ne i kemi bashkuar forcat përmes grupeve sic janë Koalicioni i Grave për Paqe dhe Lobi Rajonal i Grave për Paqe dhe Siguri, dhe kemi sjellur perspektivën e grave në diskutime politike. Ne vazhdimisht kemi shkruar letra dhe kemi mbajtur takime me nivele të larta vendimarrëse siç janë kryetari negociator Marti Ahtisaari dhe delegacionet e Këshillit të Sigurimit të KB.

Ne në RrGGK e dimë se ka mbetur edhe shumë punë për t’u bërë. Ne duhet të vazhdojmë të monitorojmë implementimin e ligjeve ekzistuese dhe funksionimin e mekanizmave institucional. Ne duhet t’u kërkojmë politikanëve të zgjedhur me vota të qytetarëve, llogari për premtimet e bëra. Ne duhet të vazhdojmë të monitorojmë misionin e ri të Bashkësisë Evropiane në Kosovë (EU-LEX) për t’u siguruar se përfaqësuesit e këtij misioni do ta implementojnë më mirë Rezolutën 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, sesa paraardhësi i tyre UNMIK-u. Së bashku me gratë nga regjioni, ne duhet të vazhdojmë të jemi zëri i paqes në Evropën Juglindore.

Dëshiroj t’i falenderoj anëtarët e RrGGK-së për përkushtimin e tyre të vazhdueshëm për rrjetin dhe përpjekjet e tyre që zëri i grave të dëgjohet. E çmoj shumë lartë, përkrahjen dhe kontributin e vazhdueshëm të anëtarëve të Bordit të RrGGK-së. Gjithashtu, falenderoj përkrahësit tonë financiar të cilët besojnë në punën tonë dhe metodat që ne i përdorim. Ne në RrGGK angazhohemi për bashkëpunim të mëtejshëm me ju dhe shpresojmë se ky do të jetë edhe një vit tjetër aktiv dhe i suksesshëm

Sinqerisht,

Igballe Rogova

Fjala e Kryetares së Bordit

Që nga themelimi i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës kaluan shumë vite pune, përkushtimi e angazhimi. Gjatë kësaj periudhe ne kemi rrugëtuar dhe punuar së bashku në realizimin e qëllimeve tona të përbashketa, në avansimin e pozitës së gruas në shoqërinë demokratike, në ofrimin e një zëri alternativ dhe përkrahës për qytetarët e Kosovës në skenën vendore dhe ndërkombetare.

Kam kënaqësinë që si kryetare e Bordit të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës të ju përgëzoj Pavarësinë e Kosovës. Kontribut të madh dhanë edhe gratë Kosovare me angazhimin maksimal e secilës grua individualisht dhe veqanërisht në forma tjera të organizuara siç është edhe RrGGK.

Raportin që keni në duart tuaja paraqet disa aspekte të orientimeve strategjike dhe aktiviteteve të RrGGK gjatë vitit 2007. Përveq përpjekjeve të vazhdueshme në ndërtimin e kapaciteteve të Rrjetit, një angazhim i veçantë është realizuar edhe në drejtim të rrjetëzimeve ndërkombëtare, në lobimin për Kosovën dhe këmbimin e informacioneve relevante në aspektet e barazisë gjinore / integritimit gjinorë dhe iniciativave në rajon e më gjërë.

Raporti në aspektin tematik, ri-parashtron aktivitetet që janë në kuadër të tri fushave tematike të RrGGK: Pjesëmarrja dhe vendimmarrja e gruas në politikë, Shëndeti i gruas dhe sfidimi i formave të ndryshme të dhunës ndaj gruas.

Me këtë rast si kryetare e zgjedhur rishtas dëshiroj të ju falenderoj për besimin që më keni dhënë (e besa edhe për obligimin), ju ftoj që të kemi një bashkëpunim reciprok dhe një përkrahje të vazhdueshme për rrjetin. Gjithashtu mos të harroj t'u shprehim falendrimet e mia të gjithë atyre që kontribuan në këtë raport. Falenderoj posaçërisht donatorët që kanë besim e respekt të veçant për Rrjetin dhe na përkrahin kurdoherë që paraqitet nevoja e organizatave anëtare të Rrjetit.

Me respekt,

Belgjzare Muharremi

Objektivat e RrGGK-së

- I. Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë, efektive dhe aktive të grave dhe vajzave në zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Kosovë;
- II. Avokimi për të drejtat njerëzore të grave në të gjitha sferat e jetës në Kosovë;
- III. Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së grupeve dhe organizatave të grave në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare si dhe në angazhimet avokuese gjegjëse.

Rreth këtij Raporti

Ky raport përbëhet nga pesë pjesë, në përputhje me pesë fushat në të cilat ka punuar Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK). Së pari, RrGGK ka vazhduar përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve të rrjetit dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për organizatat anëtare të RrGGK-së, përmes mbledhjeve të rregullta me anëtare; formimit të grupeve punuese të përbëra nga anëtarët që bashkëpunojnë në adresimin çështjeve të interesave të përbashkëta; publikimit të buletinit tremujor “Zëri i Gruas Kosovare”; përfshirjen e Bordit të drejtorëve të RrGGK-së në marrjen e vendimeve; implementimi i Kodit të Etikës dhe Përgjegjësisë të RrGGK-së; dhe pritja e vizitës së Fondit Global për Gratë (Global Fund for Women). Çështja e dytë e ndërlidhur ngushtë është se RrGGK mbetet e përkushtuar në rrjetëzimin ndërkombëtar dhe këmbimin e informatave. RrGGK ka këmbyer informata në nivelin lokal dhe ndërkombëtar përmes ueb faqes, njoftimeve përmes emailit, dhe mediave; Rrjeti i ka informuar grupet e studentëve vizitorë lidhur me situatën politike të Kosovës dhe pozitën e grave; dhe ka përkrahur përfaqësuesit e RrGGK-së, përfshirë anëtarët, që të marrin pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare.

Fushëveprimi i tretë ka të bëjë me përpjekjet e RrGGK-së që të rrisë pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimarrje përmes: përkrahjes për ndërtimin e paqes në Evropën Juglindore; sjelljes së brengave të grave kosovare pranë vendimarrësve evropianë; paraqitjes së rekomandimeve të dërguarit special i KB-së Marti Ahtisaarit lidhur me planin e tij për statusin e ardhshëm të Kosovës; bashkëpunimi me gratë udhëheqëse në politikë; këmbimi i informatave rreth Rezolutës së Kombeve të Bashkuara (RKS KB) 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë në bazat ushtarake të KFOR-it; monitorimi i implementimit të RKS KB 1325 në Kosovë; dërgimi i letrave, planifikimi strategjik dhe bashkëpunimi me Koalicionin e Grave për Paqe; avokimi i përbashkët me Lobin e Grave për Paqe dhe Siguri në Evropën Juglindore; përkrahja e deklaratës së qytetarëve për pavarësi; edukimi i votuesve për sistemin e ri zgjedhor; monitorimi fushatave elektorale dhe premtimet e kandidatëve për avokim në të ardhmen; dhe pjesëmarrja në simpozium mbi formësimin e të ardhmes së grave kosovare dhe serbe në Vjenë.

Fusha e katërt përqëndrohet në luftimin e trafikimit dhe dhunës ndaj grave: ngritja e fondeve për shfaqjen “Çdo të hëne” lidhur me qëndrimet e grave dhe rolin e saj në shoqëri; dhe përkrahja e strehimoreve dhe përpjekjet kundër dhunës në baza gjinore në Kosovë. Dhe në fund, fusha e pestë përshkruan përpjekjet për përmirësimin e qasjes në shëndetin reprodaktiv për gratë; dhe asistimi i Qendrës Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit Jeta/Vita në adresimin e kancerit të gjirit. Në përgjithësi, ky raport shërben për të informuar anëtarët, partnerët, përkrahësit dhe miqtë tanë për aktivitetet dhe të arriturat gjatë vitit 2007. Nëse ju duhen informata shtesë, ju lutem na kontaktoni në RrGGK, ose vizitoni ueb faqen tone: www.womensnetwork.org.

Ngritja e Kapaciteteve të RrGGK & Shërbimet për Anëtarët Tona

RrGGK mbajti takimin e katërt vjetor me anëtarësi

Më 9 dhjetor të vitit 2006, RrGGK mbajti takimin e tretë vjetor në restorantin “Hani i 2 Robertëve” në Prishtinë, në të cilën morën pjesë anëtarët e rrjetit, stafi i RrGGK, partnerët dhe përkrahësit. Gjatë takimit, stafi i RrGGK bëri prezantimin e aktiviteteve kryesore të rrjetit për vitin 2006: RrGGK vazhdoi të ndërtojë kapacitetet si rrjet; mori pjesë në takime lokale, rajonale dhe ndërkombëtare; bashkëpunoi me qeverinë dhe avokoi tek ta; dhe bashkëpunoi për së afërmi me organizata ndërkombëtare. Anëtarët e RrGGK gjithashtu kanë plotësuar pyetësorin vlerësues për punën e RrGGK gjatë vitit 2006. Në fund të takimit, RrGGK organizoi një lotari në të cilën tri anëtarë të RrGGK fituan shpërblime.

Anëtarët e RrGGK krijuan strategjinë e rrjetit për vitin 2007

Pas takimit të katërt vjetor të anëtarësisë, anëtarët e rrjetit diskutuan mbi strategjinë dhe prioritetet e RrGGK-së për vitin 2007. Anëtarët krijuan grupe punuese për të diskutuar mbi strategjinë e RrGGK-së për vitin 2007, që përmbante tri objektiva: 1) fuqizimi i pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimarrje; 2) përmirësimi i shëndetit të grave; 3) luftimi i trafikimit të grave dhe vajzave. Anëtarët e rrjetit që kanë ekspertizë në këto fusha u ndanë në grupe punuese dhe filluan me sajimin e strategjisë së RrGGK dhe të mekanizmave për implementimin e saj.

Grupi punues i RrGGK që adresonte çështjen e trafikimit të grave dhe vajzave vendosi që të fokusohet në parandalimin dhe ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Organizatat që punojnë me viktimat e trafikimit vazhduan të ofrojnë asistencë të drejtpërdrejtë, ndërsa organizatat e specializuara në ngritje të vetëdijes udhëhoqën fushata me qëllim të parandalimit. Grupi punues diskutoi mbi rolin e rrjetit në adresimin e trafikimit, përkrahësit potencialë të veprimtarive të tyre, mbi institucionet tek të cilat do duhej avokuar në nivel lokal dhe qendror, dhe procedurat standarde të veprimit, në veçanti në viset rurale.

Grupi punues i RrGGK-së që punoi në fuqizimin e grave në politikë dhe vendimarrje u përqendrua në mënyrat e përkrahjes së përfshirjes së grave në politikë dhe vendimarrje. Ato diskutuan mbi projekte për fuqizimin e grave në politikë dhe vendimarrje si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror. Ato gjithashtu diskutuan mbi mënyrat e implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit për arritjen e Barazisë Gjinore në Kosovë, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin mbi Zgjedhjet, dhe mekanizmat për barazi gjinore.

Grupi i tretë u përqendrua në përmirësimin e shëndetit të grave, në veçanti të grave me aftësi të kufizuara, grave të prekura nga lufta, dhe grave të moshuara. Grupi diskutoi lidhur me krijimin e një rrjeti të organi-

zatave me interesa të ngjashme; ofrimin e trajnimeve dhe këshillave lidhur me shëndetin; avokimin për përkrahje institucionale për të gjitha shërbimet shëndetësore; dhe kërkimin nga institucionet lokale që të përkrahin punën e organizatave anëtare. Caqet kryesore të këtij grupi ishin organizimi i fushatave për ngritje të vetëdijes mbi shëndetin e grave dhe avokimi për implementimin e mekanizmave ligjorë që mbrojnë shëndetin e grave.

Të tri grupet punuese ishin të përfshira në organizimin dhe zbatimin e programeve dhe aktiviteteve të përkrahura më tej në këtë raport.

RrGGK organizoi katër takime dymujore

Takimet dymujore të RrGGK shërbyen si forum përmes të cilit anëtarët pranuan informata të azhurnuara mbi programet e RrGGK, këmbyen informatat dhe përvojat me njëra tjetrën dhe iniciuan aktivitete të përbashkëta. Këto katër takime u mbajtën më 5 shkurt, 2 prill, 4 qershor dhe 10 shtator të vitit 2007.

RrGGK vazhdoi me publikimin e buletinit informativ tremujor

RrGGK vazhdoi me publikimin e buletinit informativ “Zëri i Grave Kosovare”. Katër botimet e buletinit tremujor të RrGGK përmbanin informata mbi aktivitetet e RrGGK dhe të anëtareve të veta. Buletini u shpërnda në formë elektronike dhe të shtypur në tri gjuhët, shqipe, serbe dhe angleze.

RrGGK involvoi anëtarët e bordit dhe Bordi i RrGGK ka pësuar ndryshime

Bordi i RrGGK u takua dy herë gjatë vitit 2007, më datat 13 prill dhe 29 shtator. Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK ishte gjithashtu në kontakt të rregullt me anëtarët e Bordit të RrGGK, duke ofruar azhurnime përmes emailit dhe telefonit, si dhe duke kërkuar këshilla sipas nevojës.

Në vjeshtë, Naxhije Buçinca dha dorëheqje nga pozita e Kryetares së Bordit, ndërsa anëtarët tjerë të bordit pranuan dorëheqjen e saj me një deklaratë. Belgjyzare Muharremi e zëvendësoi atë në pozitën e Kryetares së Bordit deri në zgjedhjen e re që do të mbahet gjatë takimit vjetor të RrGGK në dhjetor.

Anëtarët e RrGGK filluan me implementimin e Kodit mbi Etikën dhe Përgjegjësitë të RrGGK

Në vitin 2006, anëtarët e RrGGK miratuan Kodin mbi Etikën dhe Përgjegjësitë të RrGGK. Përmes këtij dokumenti përcaktohen standardet e përgjegjësisë dhe transparencës për anëtarët e RrGGK gjatë punës së mëtejme. Kodi përfshin gjashtë parime themelore: Misionin dhe Programin, Qeverisjen e Mirë, Resurset Njerëzore, Transparencën dhe Përgjegjësinë Financiare, Përgjegjësinë Qytetare dhe Partneritetet, dhe Rrjetëzimin. Fakti më i rëndësishëm është se kodi parashihet t'i asistojë anëtarët në ndërtimin e kapaciteteve të tyre si organizata për një të ardhme të qëndrueshme. Anëtarët e RrGGK nënshkruan një marrëveshje për implementimin e kodit dhe filluan të punojnë drejt përfshirjes së parimeve të kodit në punën e tyre.

Në nëntor të vitit 2007, përfaqësueset e RrGGK filluan të vizitojnë organizatat anëtare të shoqëruara nga një aplikacion, i cili iu dha anëtareve për të vlerësuar përparimin e bërë drejt implementimit të kodit gjatë vitit. Shumë anëtarë kanë mbushur aplikacionet dhe përgatitur dokumentet përcjellëse, siç parashihet me këtë kod. Në fillim të vitit 2008, një komision vlerësues që përbëhet prej dy anëtarëve të bordit të RrGGK dhe tre akterë të zgjedhur nga organizatat anëtare të RrGGK gjatë takimit vjetor, u krijua për të vlerësuar nëse anëtarët kanë përm-bushur së paku 30 përqind të parimeve të përcaktuara me kod gjatë vitit 2007, që paraqet një parakusht për të qëndruar anëtare e RrGGK-së në vitin 2008. RrGGK e ka përgatitur Kodin Etik dhe të Përgjegjësisë në shqip, serbisht dhe anglisht, në mënyrë që ai të jetë i qartë për anëtarët, anëtarët potencialë në të ardhmen, partnerët, dhe donatorët potencialë (me përkrahje nga Rockefeller Brothers Fund dhe fondacioni Kvinna till Kvinna).

RrGGK ishte mikpritëse e një vizite të Fondit Global të Grave

Në prill, një përfaqësuese e Fondit Global për Gratë vizitoi Kosovën. Anëtarët e RrGGK organizuan takime në të gjitha viset e Kosovës, gjatë të cilave anëtarët nga rajone të ndryshme kishin rastin të mësojnë më shumë lidhur me Fondin Global të Grave dhe për përkrahjen që i ofrohej organizatave të udhëhequra nga gratë në Kosovë nga ai. Pas takimeve, Fondi Global për Gratë botoi një artikull mbi organizatat e grave në Kosovë në buletin informativ të tyre që shpërndahet anëmbanë botës.

Rrjetëzimi Ndërkombëtar dhe Këmbimi i Informatave

RrGGK vazhdimisht këmbu informata në rrafshin lokal dhe ndërkombëtar

RrGGK ofruan përmes ueb-faqes dhe komunikimeve përmes emailit informata për hulumtuesit, shkrimtarët dhe aktivistët anembanë botës. Për shembull, RrGGK ka korrespondencë të rregullt me The Advocacy Project, që postoi botime dhe artikuj lidhur me punën e RrGGK-së dhe anëtarëve të tij. Për më tej, përfaqësues të RrGGK morën pjesë në intervista të shumta të gazetarëve nga RTV21, RTK, KTV, Lajmi, Express, Koha Ditore, revista Teuta, Radio Dukagjini, Radio Kosova, Televizioni Opinion, një gazete ditore nga Finlanda, një reviste të gruas në Spanjë, një reviste të gruas në Francë, një gazete ditore austriake, një gazete ditore nga Suedia, kanali tetë dhe kanali një i Suedisë. Përfaqësuesit e RrGGK gjithashtu u intervistuan nga organizata ndërkombëtare, siç janë Human Rights Watch dhe Amnesty International. RrGGK ofroi informata, në veçanti ato lidhur me angazhimet e grave për të qenë pjesë e bisedimeve mbi statusin final të Kosovës, pozitën e grave në Kosovë dhe bashkëpunimin ndëretnik.

Dy grupe studentësh ndërkombëtar vizituan RrGGK-në

Më 15 dhjetor 2006, studentë nga Qendra Evropiane Ndëruniversitare për Drejta të Njeriut dhe Demokratizim, me bazë në Venedik të Italisë, vizituan RrGGK-në. Universiteti bashkëpunon me studentë nga Universiteti i Prishtinës me qëllim të vizitave të institucioneve Kosovare dhe RrGGK-së çdo vit. Gjatë takimit ata diskutuan mbi situatën aktuale politike të Kosovës dhe statusin e grave në Kosovë. Gjithashtu, më 20 shkurt 2007, një grup tjetër studentësh nga Universiteti i Torontos nga Kanadaja vizituan RrGGK. Grupi ishte i fascinuar me rolin të cilin organizatat e grave e luajtën në Kosovë para, gjatë dhe pas luftës.

Një përfaqësuese e RrGGK-së merr pjesë në Konferencën Rajonale mbi Aktivizmin e Grave

Mes datave 14-16 qershor, Advije Gashi, përfaqësuese e RrGGK nga organizata anëtare Shoqata e Juristeve “Norma”, mori pjesë në konferencën rajonale me temë “Aktivizmi i grave – përvojat dhe praktikat e mira në periudhat e pasluftës” në Banjallukë të Bosnjë e Hercegovinës, të organizuar nga Asambleja e Qytetarëve të Helsinkit në Banjallukë. Konferenca kishte për qëllim analizimin e pozitës ligjore dhe aktuale të grave në proceset paqësore

dhe zhvillimore; këmbimin e përvojave pozitive dhe negative dhe rekomandimin e aktiviteteve për të ardhmen. Gjatë konferencës, organizatat e udhëhequra nga gratë nga rajoni prezantuan shembuj dhe ndanë përvojat e aktivizmit të përbashkët, bashkëpunimit rajonal, dhe kontribuimit të grave për ndërtimin e paqes dhe zgjidhjen e konflikteve pas muftës. Advije Gashi prezantoi misionin dhe aktivitetet e RrGGK-së në këtë konferencë. Ajo gjithashtu ofroi informata lidhur me përpjekjet e grave të Kosovës për të integruar pakicat në shoqërinë Kosovare. Pjesëmarrëset gjithashtu diskutuan mbi stereotipet gjinore në media dhe politikat redaktuese të gazetarëve. Pjesëmarrësit u befasuan kur kuptuan se disa media në Kosovë udhëhiqeshin nga gratë, tha Gashi.

Përfaqësuesja e RrGGK-së u ftua në Konferencën e Parë Ndërkombëtare të Iniciativës së Nobelit për Gratë

Iniciativa e Nobelit për Gratë mbajti Konferencën e Parë Ndërkombëtare të Grave, në Galway të Irlandës, më 29-31 maj, me temën “Gratë në ridefinimin e paqes për lindjen e mesme dhe gjetiu”. Tetëdhjetë aktiviste për drejta të grave nga 30 shtete u ftuan në këtë konferencë, përfshirë Drejtoreshën Ekzekutive të RrGGK-së Igballe Rogova. Aktiviste nga vise të ndryshme të botës, përfshirë ish të burgosura politike, themeluese të organizata ndërkombëtare të të drejtave të gruas, ekspertë për çarmatim, dhe aktivistet më premtuese të reja iu bashkëngjitën këtij diskutimi, që kishte për qëllim thellimin e të kuptuarit të mënyrës se si ndërlihet dinamika e dhunës ndaj gruas, e kryer në rrafshin privat dhe publik, me vështrim të posaçëm në situatën në Lindjen e Mesme. Më tej, u tha se zgjidhjet duhet të reflektojnë një qasje shumë më integruese.

Iniciativa e Nobelit për Gratë u themelua në vitin 2006, nga Laureatët e Çmimit Nobel Jody Williams, Shirin Ebadi, Wangari Maathai, Rigoberta Menchú Tum, Betty Williams, dhe Mairead Corrigan Maguire. Gjashtë gra që përfaqësonin Amerikën e Veriut dhe të Jugut, Evropën, Lindjen e Mesme dhe Afrikën, vendosën që të bashkojnë përvojat e jashtëzakonshme në një përpjekje të bashkuar drejt paqes së përshtuar nga drejtësia dhe barazia.

RrGGK merr pjesë në një seminar mbi GEM dhe Teknologjitë Informative dhe të Komunikimit

Më 19-21 tetor, dy përfaqësuese të RrGGK-së morën pjesë në një seminar rajonal mbi Metodologjinë e Vlerësimit Gjinor në Sarajevë, të organizuar nga One World Platform for Southeast Europe (OWPSEE) me përkrahje nga Shoqata për Komunikime Progresive (APC) dhe ZaMirNet. Seminari kishte për qëllim diskutimin e çështjeve të lidhura me të drejtat e grave, me një fokus të posaçëm në integrimin e çështjeve gjinore në Teknologjitë Informative

dhe të Komunikimit. Konferenca rezultoi me një rrjet të ri rajonal, përmes të cilit pjesëmarrësit e konferencës planifikojnë të ndajnë informata rregullisht.

RrGGK merr pjesë në një takim rajonal të organizuar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna

Më 2-4 nëntor, Fondacioni Kvinna till Kvinna (KtK) mbajti takimin rajonal në Shqipëri. Pasi që KtK bashkëpunon me organizata lokale të grave që gjenerojnë projekte vet në bazë të nevojave të shoqërisë së tyre, ata i mbledhën organizatat e tyre partnere nga Kosova e Shqipëria për të diskutuar mbi brengat e grave dhe si KtK mund të kontribuojë adresimin e kësaj çështje në rajon. Pjesëmarrësit u ndanë në dy grupe punuese: gratë në vendimmarrje dhe dhuna ndaj gruas. Gjatë punës në grupe punuese, gratë nga Kosova dhe Shqipëria diskutuan mbi faktorët kauzalë që ndikojnë në këto çështje dhe mbi mënyrat e bashkëpunimit të mundshëm rajonal. Ato gjithashtu diskutuan mbi fushatat e ardhme rajonale.

Përfaqësuesja e RrGGK-së foli lidhur me Rezolutën 1325

Veprorë Shehu, Drejtore e organizatës anëtare të RrGGK, Medica Kosova, mori pjesë në një konferencë të organizuar në Vjenë lidhur me Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me ç'rast prezantoi punën e RrGGK dhe organizatave tjera Kosovare drejt implementimit të rezolutës.

Ngritja e Nivelit të Pjesëmarrjes së Grave në Politikë dhe Vendimmarrje

Veprimet e grave: RrGGK përkrah ndërtimin e paqes në Evropën Juglindore

Më 19 prill, në "Samitin e Grave për Paqe të Qëndrueshme në Evropën Juglindore", Lobi Rajonal i Grave për Paqe dhe Siguri në Evropën Juglindore, që përfshin gra nga politika dhe shoqëria civile nga Bosnjë e Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe Kosova u takua në Vjenë. Gjatë takimit, ato diskutuan mbi situatën politike në vendet e tyre dhe lidhur me mënyrën në të cilën mund të kenë ato ndikim në zgjidhjet paqësore të konflikteve politike në rajon. Pjesëmarrëset krijuan strategjinë për vitin 2007. Samiti u përmbyll me një deklaratë të shkruar nga Lobi Rajonal i Grave, e cila iu dërgua Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në deklaratë thuhej:

Lobi shpreh përkrahjen e fuqishme për propozimin e Ahtisaarit për statusin e ardhshëm të Kosovës; Lobi inkurajon Këshillin e Sigurimit që të garantojë që rezoluta e re mbi Kosovën të njeh të drejtën për siguri njerëzore për të gjitha gratë dhe burrat si gurthemel për paqe të qëndrueshme në Kosovë dhe rajon; Lobi mirëpret standardet e larta të përcaktuara nga propozimi i Z.Ahtisaari lidhur me mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve etnike dhe fetare dhe integrimin e plotë të tyre në shoqërinë Kosovare, dhe; Lobi Rajonal i Grave njeh të drejtën e të zhvendosurve për tu kthyer në Kosovë, dhe faktin që Qeveria e Kosovës duhet të përkrahë integrimin e tyre.

RrGGK mori përsipër organizimin logjistik dhe procedural të takimit të Lobit Rajonal të Grave, me përkrahje financiare nga UNDEF dhe UNIFEM.

RrGGK sjell brengat e grave para vendimmarrësve evropianë

Gjatë një konference në Berlin, me temën "Shtegu drejt 1325: Perspektiva Gjinore në Bashkimin Evropian (BE)", të mbajtur më 4-6 maj, Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së Igballe Rogova përshkroi betejat me të cilat përballëshin gratë në Kosovë gjatë avokimit për zbatimin e Rezolutës 1325 tek Misioni i Organizatës së Kombeve të

Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Ajo rekomandoi që misioni i ardhshëm i Bashkimit Evropian në Kosovë të mësojë nga sukseset dhe dështimet e UNMIK-ut, Në veçanti, ajo kërkoi që misioni i BE-së të përfshijë gratë Kosovare në të gjitha proceset vendimmarrëse.

RrGGK prezantoi rekomandimet pas shpalesjes së planit të Ahtisaarit

Më 7 maj, Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK Igballe Rogova foli gjatë një seminari të organizuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) në Suedi me temën “Kosova: rruga drejt pavarësisë”. Ajo foli pas prezantimit të propozimit për statusin e ardhshëm të Kosovës nga i deleguari i posaçëm i OKB-së për Procesin e Statusit Final të Kosovës, Martti Ahtisaari për vendimmarrësit e lartë të BE-së që ishin të pranishëm në këtë seminar.

Rogova prezantoi tentativat e Kosovareve për të integruar serbët në Kosovë, duke përfshirë punën e Koalicionit Paqësor të Grave që afroi aktivistet Serbe dhe Shqiptare që nga viti 2006. Ajo tha se politikanët në Beograd inkurajojnë serbët në Kosovë që të mos integrohen dhe manipulonin me ta. Ajo paraqiti një shembull se si përfaqësuesit e delegacionit serb urdhëronin komunitetin serb që të mos bashkëpunojë me shqiptarët. Në përfundim, Rogova theksoi brengën e saj për aktivistet paqësore në Serbi të cilat kërcënoheshin përditë nga qeveria e Serbisë. Kërcënimet vinin pasi që ato publikisht përkrahën pavarësimin e Kosovës. Ajo rekomandoi që Ministria e Punëve të Jashtme e Suedisë të bëjë presion mbi qeverinë Serbe për të gjykuar këto kërcënime dhe për të siguruar sigurinë e aktivisteve në Serbi.

Mes të pranishmëve në këtë seminar ishin ambasadorët nga Rusia, Serbia dhe Shqipëria; përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Suedisë; Ann-Sofie Nilsson – Shefe e Zyrës Suedeze në Kosovë; përfaqësuesit të Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), organizata të ndryshme suedeze; dhe pjesëtarë të diasporës Serbe dhe Kosovare.

RrGGK vazhdon bashkëpunimin me lideret politike

Gjatë vitit 2007, RrGGK bashkëpunoi me institucione qeveritare në mënyra të ndryshme. Më 23 mars, Komiteti Drejtues i Grave në Kuvendin e Kosovës ftoi përfaqësuesit e rrjetit në tryezën e rrumbullakët me temën “Gratë dhe Zgjedhjet”. Tryeza e rrumbullakët kishte për qëllim të identifikojë mënyrat për bashkëpunim mes grave në politike dhe atyre në shoqërinë civile, si dhe diskutimin e Ligjit mbi Zgjedhjet.

Në prill, Agjencia për Barazi Gjinore e Zyrës së Kryeministrit mbajti një takim në të cilin prezantoi një

Memorandum Mirëkuptimi. Ky dokument përcaktonte të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga bashkëpunimi mes organizatave joqeveritare dhe Agjencisë për Barazi Gjinore. Më 24 maj, RrGGK nënshkroi një dokument fillestar e më pas edhe Memorandumin e Mirëkuptimit, me të cilin përcaktohej fushëveprimi i saktë i RrGGK-së dhe Agjencisë në bashkëpunimin relevant. Gjatë tërë procesit, RrGGK kishte bisedime me përfaqësuesit e Komitetit Drejtues të Grave në Kuvendin e Kosovës.

Përfaqësuesit e RrGGK gjithashtu morën pjesë në një takim të organizuar mes zyrtarëve qeveritarë dhe organizatave joqeveritare. Si rezultat i këtij koordinimi të vazhdueshëm, Ministresha e Shërbimeve Publike njohu dhe përkrahu punën e organizatave të shoqërisë civile, në veçanti të aktivisteve.

Në maj, zyrtarët nga Ministria e Shërbimeve Publike miratuan një Udhëzimin Administrativ Nr. 2007/03 mbi “Masat për arritjen e barazisë gjinore në institucionet e administratës publike.” RrGGK mirëpriti këtë udhëzim, i cili sinjalizon vullnetin e qeverisë për të përkrahur përmirësimin e pozitës së gruas në Kosovë.

Gjatë zgjedhjeve, RrGGK bashkëpunoi me Komitetin Drejtues të Grave dhe Deputetet e Kuvendit të Kosovës, për të diskutuar mbi mënyrën se si gratë nga shoqëria civile mund të përkrahin gratë në politikë në qasjen e tyre ndaj votuesve gjatë fushatave paraelektorale. Për këtë dhe aspekte tjera të bashkëpunimit me gratë në politikë, RrGGK pranon përkrahje të vazhdueshme nga UNIFEM.

RrGGK ofron informata mbi gratë, Rezolutën 1325 në Bazat Ushtarake të KFOR-it

Në korrik RrGGK filloi një seri të seancave joformale që mbahen në bazat ushtarake të KFOR-it. Stafit i RrGGK ofroi informata lidhur me shoqërinë Kosovare, gratë në Kosovë, dhe Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi gratë, paqen dhe sigurinë. RrGGK ka vizituar nga dy herë kampet ushtarake të KFOR-it finlandez, suedez dhe irlandez.

Në kampin finlandez, Shehindere Dedushi nga Flaka, organizatë anëtare e RrGGK-së që funksionon në këtë rajon, ndau problemet me të cilat përballeshin qytetarët e rajonit të Lipjanit. Takimi ofroi mundësi rrjetëzimi dhe përfaqësuesit e KFOR-it u sigurua një kontakt lokal tek i cili mund t'i referojnë rastet tek të cilat hasin gjatë patrullimit. Në disa kampe RrGGK shfaqti dokumentarin “Who’s Security?”, i cili u shfrytëzua pas marrjes së lejes nga producenti Crossing Bridges. Filmi ekzaminon çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë njerëzore, me të cilat përballeshin gratë, dhe implementimin e Rezolutës 1325 në Kosovë. Filmi shërbente si katalizator për pyetje dhe debat interesant. Që nga viti 2000, RrGGK avokoi tek KFOR-i për të përfshirë aktivistet si trajnere për trupat e

KFOR-it që arrijnë Kosovë. Përmes seancave të tilla, aktivistet do të mund të thyenin paragjykimet paraprake lidhur me gratë Kosovare, ngritnin vetëdijen lidhur me Rezolutën 1325 dhe adresonin çështjet tjera kritike, siç janë lidhja mes bazave të KFOR-it, prostitucioni dhe trafikimi me gra. Megjithatë, para korrikut të vitit 2007 vetëm një vizitë ishte bërë në bazën e KFOR-it suedez në vitin 2005, pas avokimit të bërë nga Fondacioni Kvinna till Kvinna. Një rundë e re seancash joformale janë ndërmarrë duke iu falënderuar angazhimit të Carl Henrik Assargard, ish-këshilltarit politik në Selinë e Forcës Shumëkombëshe të KFOR-it, i cili aranzhoi mbajtjen e kësaj serie seancash joformale.

RrGGK monitoron implementimin e Rezolutës 1325 në Kosovë

Me fillim në muajin qershor, një ekip hulumtues i RrGGK intervistoi figurat kyçe të jetës publike Kosovare për të dokumentuar dhe vlerësuar implementimin e Rezolutës 1325 në Kosovë. Hulumtimi i tyre përfshinte intervista me politikanë lokalë, aktivistë të shoqërisë civile, punonjës të UNMIK-ut, dhe figura tjera udhëheqëse. Hulumtimi kishte për qëllim përcaktimin e faktit nëse rezoluta mbi gratë, paqen dhe sigurinë, e miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së në vitin 2000, e zbatueshme për të gjitha shtetet, është implementuar në Kosovë gjatë tetë viteve të fundit. Rezoluta mbuloi fushat siç janë përfshirja e grave në vendimmarrje dhe ndërtim të paqes, tentativat për të kanalizuar vetëdijen mbi çështjet gjinore në misionet paqeruajtëse, dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna në baza gjinore gjatë dhe pas konfliktit.

Profesoresha Lynne Alice nga Deakin University i Australisë ishte udhëheqëse e këtij hulumtimi.

Ekipi hulumtues i RrGGK-së (nga këndi i majtë): Elizabeth Carolan, Dafina Beqiri, Albana Lumi, Ali Misimi, dhe Lynne Alice.



Që nga koha e angazhimit të saj në Universitetin e Prishtinës në vitet 2001 deri 2003, ajo ishte kthyer në Kosovë disa herë për të asistuar iniciativë të ndryshme të shoqërisë civile dhe universitetit. Ajo kaloi dy muaj duke mbikëqyrur hulumtimin e kryer nga një ekip vendor hulumtues: të përbërë nga Dafina Beqiri, Albana Lumi, dhe Ali Misimi. Elizabeth Carolan, praktikante nga Irlanda gjithashtu ndihmoi këtë hulumtim. Hulumtimi u përkrah nga UNDEF dhe UNIFEM.

Zena Zenama ndërmori një projekt të ngjashëm hulumtues në Bosnjë e Hercegovinë. Lynne Alice dhe anëtarët e ekipit hulumtues udhëtuan në Sarajevë në muajin shtator për të asistuar në fazat përfundimtare të mbledhjes së të dhënave atje. Në përvjetorin e shtatë të Rezolutës 1325 më 31 tetor, një përmbledhje ekzekutive e këtij raporti u shpërnda përmes raportit tek një audiencë e gjerë. RrGGK planifikon të publikojë raportin final më 5 dhjetor në Grand Hotel në Prishtinë.

Koalicioni i Grave për Paqe vazhdoi me avokimin përmes kumtesave

Koalicioni i Grave për Paqe u themelua në vitin 2006 nga RrGGK dhe Rrjeti i Grave në të Zeza nga Serbia, në kontekst të negociatave lidhur me statusin politik të Kosovës. KGP është një iniciativë e pavarur qytetare e themeluar mbi bazat e solidaritetit të grave, që tejkalon barrierat, kufizimet dhe ndarjet kombëtare, etnike dhe fetare. Më 12 shkurt, Koalicioni i Grave për Paqe i dërgoi një letër Z. Ahtisaari, të deleguarit të OKB-së për Negociatat për Statusin e Ardhshëm të Kosovës, për ta përkujtuar atë, ekipet negociatore dhe komunitetin ndërkombëtar për çështjet kryesore që duhet t'i kenë parasysh gjatë negociatave. Për të gjetur të gjitha letrat e KGP, vizitoni: www.womensnetwork.org.

Koalicioni i Grave për Paqe hartoi planet e veta për të ardhmen

Më 29 mars, grupi strategjik i KGP u takua në zyrat e RrGGK në Prishtinë. Gjatë takimit, grupi diskutoi mbi aktivitetet e mëparme të koalicionit. Gjithashtu u analizua efekti i zhvillimeve të fundit politike në Kosovë dhe Serbi tek aktivistet në dy vendet. Koalicioni formuloi strategjinë dhe aktivitetet për vitin 2007, që përfshijnë takime të vazhdueshme koordinuese, përgatitjen e materialeve për promovim të koalicionit dhe përgatitjen e një filmi dokumentar mbi punën e KGP. RTV21 ofroi produktionin e këtij filmi pa pagesë. Koalicioni gjithashtu planifikon të përkrah edhe më tej rrjetëzimin mes organizatave të grave nga Kosova dhe Serbia, si dhe vazhdimin e avokimit ndërkombëtar. Gjatë takimit, përfaqësueset e UNIFEM-it ofruan përkrahje dhe sugjerime pragmatike për aktivitetet e ardhme të koalicionit. UNDEF përkrahu financiarisht këtë takim.

KGP mbajti Konferencën e vet të dytë vjetore: “Përmes solidaritetit të grave drejt paqes së drejtë”

Më se gjashtëdhjetë aktiviste që përfaqësonin organizata të grave serbe dhe shqiptare nga Kosova dhe Serbia u takuan në Strugë të Maqedonisë nga data 31 gusht deri më 3 shtator, për të mbajtur kësaj Konferencën e dytë vjetore të Koalicionit të Grave për Paqe, me titullin “Përmes solidaritetit të grave drejt paqes së drejtë”. Konferencën e hapën Osnat Lubrani nga UNIFEM, Stasa Zajovic nga Rrjeti i Grave në të Zeza nga Serbia dhe Igballe Rogova nga RrGGK. Gjatë panelit të parë Stasa Zajovic theksoi rëndësinë e qasjes feministe ndaj drejtësisë tranzicionale, dhe Milos Urošević ofroi shembuj specifikë të mënyrave në të cilat GZ përkrahin proceset e drejtësisë tranzicionale, mes tjerash, duke vizituar të mbijetuarit e luftës dhe duke monitoruar proceset gjyqësore kundër kriminelëve të luftës. Pas diskutimit të Veprorë Shehut mbi drejtësinë për gratë të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale, Nexhmije Fetahu prezantoi sfidat potenciale me të cilat gratë në shoqërinë civile mund të përballen gjatë përkrahjes së drejtësisë tranzicionale. Grupet punuese elaboruan më tej fjalimet e panelisteve.

Atë mbrëmje, anëtarët e koalicionit morën pjesë në një performansë rrugore në qendër të qytetit të Strugës. Turistët



kureshtarë dhe qytetarët vendas u ndalën për ta shikuar performansën, e cila simbolikisht kërkonte nëse është më mirë që paratë e taksapaguesve të shpenzohen për ushqim dhe ndihma apo për ushtri. Përderisa disa anëtarë të KGP aktronin në performansë, disa të tjera mbanin shenja në përkrahje të paqes dhe diskutonin me kalimtarët mbi fletushkat që u shpërndanin.

Në ditën e dytë të konferencës Haya Shalom nga Gratë në të Zeza nga Izraeli, Marija Perkovic, Jasmina Mitrinovic, Mima Rasic, Igballe Rogova, dhe Flora Macula folën lidhur me solidaritetin e grave, paqen dhe sigurinë. Pjeësuarret më tej patën një seancë në të cilën paraqitën idetë lidhur me veprimet konkrete të cilat KGP do duhej ndër-marrë gjatë vitit vijues. Një nga rezultatet e kësaj seance ishte edhe vizita e anëtarëve të KGP në enklavat serbe në Kosovë.

Duke dëshmuar suksesin e performansës rrugore një natë më parë, aktivistet gjithashtu shpresonin të rrisin vizibilitetin e KGP dhe të angazhimeve të grave për paqe duke tejkuluar kufijtë shtetëror e etnikë e duke bërë performansa të tilla në të gjitha viset e Kosovës. Anëtarët serbe shprehën interes që të vizitojnë komunitetet Kosovare të prekura nga lufta, siç është Suhareka, në mënyrë që të takohen me gratë dhe të ndajnë përvojat e tyre personale. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e këmbimit dhe dokumentimit të historive personale të shqiptarëve dhe serbëve si pjesë e proceseve të drejtësisë tranzicionale. Raporti i konferencës që do të publikohet në fillim të vitit 2008 do të theksojë konkretisht planet e veprimit dhe përfshijë të gjitha veprimet e ndërmarra në konferencë.

Konferenca vazhdoi të bazohet në themelet e fuqishme të krijuara gjatë konferencës nga viti i kaluar, e cila fokusohet në ndërtim të besimit të ndërsjellë dhe rritjen e nivelit të koordinimit dhe bashkëpunimit mes organizatave serbe dhe shqiptare nga Kosova dhe Serbia. Aktivisteve kosovare dhe serbe iu bashkëngjiten mysafire speciale nga vise të ndryshme të botës, përfshirë përfaqësueset e Fondacionit Kvinna till Kvinna, UNIFEM, Urgent Action Fund, dhe Grave në të Zeza nga Izraeli. UNDEF dhe UNIFEM përkrahën këtë konferencë.

Në pajtim me rekomandimet nga konferenca, me qëllim të përmirësimit të nivelit të këmbimit të informatave mes aktivisteve të Kosovës dhe Serbisë, RrGGK i dërgoi informatat e kontaktit të organizatave anëtare të Rrjetit tek Rrjeti i Grave në të Zeza nga Serbia menjëherë pas konferencës. Në nëntor, RrGGK i dërgoi RRGZ deklaratën e parë dymujore mbi situatën e sigurisë në Kosovë, në mënyrë që t'i informojë ata mbi zhvillimet e fundit politike dhe të sigurisë.

Lobi Rajonal i Grave bën që prioritetet e grave të dëgjohen në qarqe ndërkombëtare

Lobi Rajonal i Grave (LRG) për Paqe dhe Siguri në Evropën Juglindore ka lëshuar tri deklarata gjatë vitit 2007, ndërsa RrGGK pati një rol aktiv në shpërndarjen e këtyre deklaratave lokalisht dhe ndërkombëtarisht. Një përfaqësues i RrGGK gjithashtu shërbeu si person kontaktues në Kosovë për të gjitha pyetjet dhe intervistat e mëtejme lidhur me deklaratat. Më 19 prill, LRG i shkroi një letër Këshillit të Sigurimit të OKB-së duke kërkuar të takohet me misionin faktmbledhës të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që do vizitonte Prishtinën dhe Beogradin gjatë muajit. Si rezultat i kësaj letre dhe avokimit të fuqishëm nga UNIFEM-i, anëtarët e LRG u ftuan për një takim joformal në Prishtinë me misionin faktmbledhës të Këshillit të Sigurimit, me ç'rast, mes tjerash, avokuan për përkrahje ndërkombëtare për propozimin mbi statusin e ardhshëm të Kosovës, inkurajuan përpilimin e një rezolute të re mbi statusin politik të Kosovës, dhe rekomanduan që gratë të jenë më shumë të pranishme në bisedimet e ardhme politike, siç edhe përcaktohet me Rezolutën 1325.

Më 20 prill, LRG përpiloi një letër tjetër përmes së cilës kërkohej nga Republika e Serbisë që të zbulojë dokumentet e censuruara. Më tej, më 7 shtator, LRG lëshoi një deklaratë me të cilën kërkonte përkrahje për kandidatet femra në zgjedhjet kombëtare. Të gjitha deklaratat mund të gjenden në ueb-faqen: www.womensnetwork.org.

Qytetarët në mënyrë simbolike shpallin pavarësinë e Kosovës

Më 23 korrik, qytetarët kërkuar që të përcaktohet një datë për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës. Manifestimi në Prishtinë rezultoi nga takimet e mbajtura nga një koalicion ad-hoc i grupeve lokale të shoqërisë civile, përfshirë edhe RrGGK. Koalicioni u krijua për të koordinuar veprimet që rrjedhin nga prolongimet e negociatave, në momentin kur Këshilli i Sigurimit kishte vendosur që të vazhdojë me bisedime pas dorëzimit të planit të Ahtisaarit. Të mbledhur para Teatrit Kombëtar, protestuesit deklaruan pavarësinë e Kosovës si gjest simbolik i dizajnuar për të bërë presion tek vendimmarrësit vendorë dhe ndërkombëtarë për të mos shtyrë më tej procesin.

Pas shpalljes qytetarët vallëzuan në rrugë. Ngjarja përfundoi në mënyrë paqësore. Ky manifestim u organizua në kohën e mbajtjes së takimit mes delegacionit qeveritar Kosovar dhe Sekretares së Shtetit të SHBA-ve në Uashington, ku diskutoheshin nyja politike e shkaktuar nga statusi i Kosovës. Në protestë morën pjesë rreth 200 persona dhe u mbulua nga mediat në Kosovë dhe jashtë saj.



Qytetarët vallëzuan në qendër të Prishtinës pas shpalljes simbolike të pavarësisë së Kosovës.

RrGGK edukon votuesit lidhur me kandidatet në zgjedhje dhe me sistemin e ri zgjedhor

Në nëntor, RrGGK bashkëpunoi me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe UNIFEM-in për të edukuar votuesit lidhur me sistemin e ri zgjedhor në Kosovë dhe për t'i njoftuar me kandidatet që merrnin pjesë në zgjedhje. Organizatat anëtare të RrGGK aranzhuan takime në të cilat morën pjesë më se një mijë qytetarë që përfaqësonin të gjitha grupet etnike anembanë Kosovës. Gjatë takimeve, anëtarët e RrGGK ofronin këshilla lidhur me shfrytëzimin e sistemit të ri elektoral me lista të hapura, si dhe shpërndanin një publikim që barte informata lidhur me kandidatet që gjendeshin në lista zgjedhore, të përgatitur nga Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore. Përfaqësues të RrGGK gjithashtu u paraqitën në programe të mediave lokale për të sqaruar sistemin zgjedhor.

RrGGK monitoroi premtimet nga fushata zgjedhore

Që nga viti 1999, liderët politikë Kosovare kanë shfrytëzuar statusin final politik si arsytim për dështimet në përbushjen e nevojave të përditshme të qytetarëve. Pasi që të jetë zgjedhur statusi politik i Kosovës, do të shfaqen në pah çështje të ndryshme sociale që paraqesin barrë për shoqërinë Kosovare (siç janë papunësia, rrugët e këqija, rryma jokonsistente, dhe mungesa e ujit). Politikanët nuk do të kenë mundësi të fshihen pas administratës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara në rast se dështojnë në përbushjen e nevojave të qytetarëve të Kosovës. Njëkohësisht, zgjedhjet e nëntorit u bënë sipas listave të hapura zgjedhore, përmes të cilave qytetarët zgjedhën individë e jo parti politike. Sistemi i ri zgjedhor i mundëson qytetarit kërkimin e përgjegjësisë nga vendimmarrësit. Tani qytetarët kanë mundësi të monitorojnë se si zyrtarët e zgjedhur dhe partitë politike janë duke përbushur nevojat e tyre dhe premtimet e dhëna gjatë fushatave zgjedhore.

Në tetor dhe nëntor të vitit 2007, me përkrahje nga Trusti Ballkanik për Demokraci, RrGGK ka filluar monitorimin e premtimeve të politikanëve dhe partive politike të dhëna për qytetarët në media, gjatë fushatës parazgjedhore, si dhe kanë bërë mbledhjen e platformave të partive politike. Në të ardhmen, RrGGK do t'i shfrytëzojë këto për t'i ndihmuar qytetarëve në kërkimin e përgjegjësisë nga zyrtarët të cilët i kanë bërë premtimet.

RrGGK merr pjesë në simpoziumin e Vienës

Një përfaqësues i RrGGK, organizatat anëtare të RrGGK, dhe eksperte që përfaqësonin fusha të ndryshme të jetës në Kosovë, morën pjesë në simpoziumin e quajtur "Formësimi i të Ardhmes Sonë Evropiane – Rrjetëzimi i Grave Serbe dhe Kosovare" në Vjenë, më 5-6 nëntor 2007. Gra nga Serbia dhe Kosova u ndanë në dy grupe punuese për të diskutuar mbi çështjet "Arsimi – Strategji për Zhvillimin e Identitetit Evropian", "Media – Strategji për Parandalim të Konfliktëve dhe Pajtim duke Ndryshuar Imazhin për 'tjetrin'", dhe "Çështjet Ekonomike dhe Sociale – Strategjitë për të Ngritur Pjesëmarrjen e Grave". Pjesëmarrësit e konferencës prezantuan rekomandimet e tyre para Ministrit Federal Austriak për Çështje Evropiane dhe Ndërkombëtare, Ursula Plassnik dhe vendimmarrësve ndërkombëtarë prezent në këtë konferencë.

Luftimi i Trafikimit dhe Dhunës ndaj Grave

"Çdo të hënë" lanson fushatën e vet

Më 8 mars, në Teatrin Oda u lansua fushata kundër dhunës ndaj grave, përmes shfaqjes së skenaristes Italiane Sara Bogatti të quajtur "Çdo të hënë në 1:30 pasdite", me sponsorim të MAMACASH. RrGGK ka ndihmuar në nxjerrjen e fondeve për këtë shfaqje të mirënjohur e cila është një nga shfaqjet më me renome në Itali sa i përket çështjeve të grave dhe qëndrimit të tyre lidhur me rolin e tyre në shoqëri. Kjo shfaqje me një akt portretizonte tri gra intelektuale të cilat takoheshin në bankë të një parku një herë në javë për të diskutuar lidhur me atë se si është të jesh femër në një shoqëri moderne. Të gjitha gratë e suksesshme karrieriste ende përballeshin me probleme të ndryshme profesionale dhe emocionale gjatë punës që bëjnë me kolegë meshkuj.

Në formë të komedisë së lehtë, kjo shfaqje barti mesazhin e vet lehtë në mënyrë universale, duke tejkuluar kufijtë kulturor apo kombëtar. Shfaqja ishte produksion ekskluzivisht i grave: regjisore Burbuqe Berisha, asistent regjie Shota Bukoshi, skenografe Rozafa Basha, kostumografe Iliriana Loxha-Basha, grimi Labinote Geci, dhe aktore: Ilire Vinca-Çelaj, Anisa Ismaili, dhe Arberesha Grabovci-Nixha.



Anisa Ismaili dhe Ilire Vinca-Çelaj duke performuar një pjesë nga "Çdo të Hënë", në mbledhjen vjetore 2006, të RrGGK-së.

RrGGK përkrah strehimoret dhe angazhimet kundër dhunës në baza gjinore

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2007, RrGGK ishte aktivisht i involvuar në një projekt të quajtur “Ofrimi i Sigurisë, Promovimi i Shëndetit; Luftimi i Dhunës në Baza Gjinore në Kosovë”, përkrahur nga Fondi Popullor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNFPA). Kosovës i mungon infrastruktura e domosdoshme për të përkrahur gratë dhe fëmijët që vuajnë nga dhuna në baza gjinore. Strehimoret ekzistuese që mbrojnë viktimat e dhunës nuk kanë përkrahje të mjaftueshme financiare për të ofruar kujdes adekuat shëndetësor për viktimat, për t'i mbrojtur ata në mënyrë adekuate, dhe për t'i ndihmuar në integrimin e serishëm në shoqëri. Përveç kësaj, ekziston një mungesë e koordinimit konsistent mes të gjithë akterëve që punojnë në çështjet e dhunës në baza gjinore.

RrGGK u përfshi në këtë projekt duke tentuar të ndihmojë ngritjen e nivelit të përkrahjes financiare si dhe të përkrahë themelimin e sistemeve specifike të bashkëpunimit mes strehimoreve, krahas mbrojtjes, asistimit dhe përkrahjes së viktimave të dhunës. Gjatë këtij projekti gjashtëmuor, me përkrahje të UNFPA, RrGGK ofroi përkrahje të drejtpërdrejt për katër strehimore në Kosovë. Partnerët e RrGGK në këtë projekt kanë mbajtur takime të rregullta koordinuese, gjatë të cilave kanë punuar në krijimin e procedurave specifike dhe standarde të veprimit për strehimore, si dhe kanë diskutuar mbi telashet dhe çështjet kyçe që paraqiten gjatë punës në strehimore.

Përmes këtij projekti, RrGGK në bashkëpunim me partnerët e vet, është duke kryer hulumtime zbuluese lidhur me nivelin e shtrirjes së dhunës në baza gjinore në Kosovë dhe lidhjen potenciale të saj me shëndetin reproduktiv të grave. Ky hulumtim, i pari i këtij lloji në Kosovë, ka për qëllim ofrimin e informatave më të azhuruara të mundshme lidhur me këtë çështje, si dhe përcaktimin e rekomandimeve politike të cilat do të shfrytëzohen në fushatën mediale/avokuese të RrGGK. RrGGK do të shfrytëzojë rekomandimet nga hulumtimi për të avokuar tek institucionet relevante për përkrahje të rregullt për strehimoret, si dhe për të nxjerrë rekomandime tjera politike për çështje që kuptohen nga hulumtimi.

Përmes këtij projekti, RrGGK ka organizuar fushatë mediale për ngritje të vetëdijes lidhur me problemin e dhunës ndaj gruas dhe për publikimin e rekomandimeve tek të gjithë akterët relevantë që punojnë në luftimin e dhunës ndaj grave. RrGGK dhe organizatat e veta anëtare janë duke punuar për të arritur deri tek gratë dhe burrat e viseve rurale dhe urbane, duke u sjellë atyre informata lidhur me dhunën në baza gjinore dhe ndikimin që kjo ka në shëndetin reproduktiv. Organizatat anëtare të RrGGK kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zbatimin e suksesshëm të këtij projekti, si përmes pjesëmarrjes në takime koordinuese ashtu edhe përmes përcaktimit të standardeve për strehimore, pjesëmarrjes në hulumtim apo organizimit të aspekteve të ndryshme të fushatës për informim publik.

Përmirësimi i Shëndetit të Grave

RrGGK përkrah qasjen e përmirësuar të grave ndaj kujdesit për shëndetin reproduktiv

Gjithashtu, përmes projektit të lartpërmendur të përkrahur nga UNFPA, RrGGK ka ofruar përkrahje të drejtpërdrejtë për Medica Kosova. Me këto fonde, Medica ka ofruar shërbime për gratë në vise rurale, si dhe ekzaminime pa pagesë me qëllim të zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit. Fushata mediale e RrGGK dhe diskutimet me qytetarë, të organizuara në të gjitha rajonet, gjithashtu kishin për temë kancerin e gjirit dhe problemet tjera serioze shëndetësore me të cilat gratë konfrontohen. Më tej, përmes këtij projekti janë siguruar edhe fonde për strehimoret, në mënyrë që të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime më të mira shëndetësore për gratë që qëndrojnë në to.

RrGGK dhe Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit JETA/VITA fillojnë betejën kundër kancerit të gjirit në Kosovë

Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit JETA/VITA (QKLGJ) me përkrahje nga RrGGK, organizoi një fushatë gjatë muajit mars që kishte për cak ngritjen e vetëdijes mes grave dhe shoqërisë në përgjithësi sa i përket një problemi madhor shëndetësor, siç është kanceri i gjirit. Për fat të keq, në Kosovë nuk ekzistojnë të dhëna lidhur me këtë sëmundje, por informatat nga vendet tjera të rajonit sugjerojnë se një në nëntë apo dhjetë gra vuan nga kanceri i gjirit. Kanceri paraqet shkaktarin më të shpeshtë të mortalitetit tek gratë.

Përderisa në Kosovë është ngritur niveli i paraqitjes së kancerit të gjirit, kushtet për parandalim, zbulim të hershëm dhe trajtim janë tejet të limituara. Kosovës i mungojnë kushtet elementare për luftimin e kancerit të gjirit: Instituti Onkologjik me personel të kualifikuar mjekësor dhe pajisje të domosdoshme për punë; organizimin institucional dhe social për ofrimin e trajtimit të vazhdueshëm institucional; dhe përkrahja për këto institucione dhe programe.

QKLGJ dhe RrGGK shkruan një letër për Kryeministrin dhe Ministrin e Shëndetësisë dhe kërkuan takim me ta, për të kërkuar hartimin e një Strategjie Kombëtare për Luftimin e Kancerit të Gjirit; finalizimin e ndërtimit të Institutit Onkologjik dhe funksionalizimin e tij; dhe angazhime më serioze të politikëbërësve dhe qeverisë, në veçanti sa i përket konsiderimit të kancerit si kërcënim me të cilin përballen shumë gra. Më 8 mars, RrGGK dhe QKLGJ organizuan nënshkrimin e një peticioni, duke inkurajuar qytetarët që të nënshkruajnë një peticion që thërret për implementimin e këtyre kërkesave. Përveç kësaj, përfaqësues të RrGGK dhe QKLGJ u paraqitën në

debate televizive dhe tryeza të rrumbullakëta lidhur me këtë temë. RrGGK gjithashtu avokoi për publikimin e deklaratave të shërbimeve publike në stacionet televizive kombëtare. Shtypshkronja KOHA, Kryqi i Kuq i Kosovës, dhe të gjitha mediat përkrahën këtë fushatë.



Qytetarët nënshkruajnë peticionin që i bën thirrje qeverisë të hartojë strategjinë për luftimin e kancerit të gjirit si dhe të përfundojë ndërtimin e institutit onkologjik.

Bordi i Drejtorëve i RrGGK-së

Bordi i Drejtorëve të RrGGK-së gjatë vitit 2007:

Kryetare e Bordit - Naxhije Buçinca (Veteranet e Arsimit)
 Behar Selimi, (Shërbimi Policor i Kosovës)
 Belgjzare Muharremi, (Dera e Hapur)
 Besim M. Kajtazi, (Ministria e Shërbimeve Publike)
 Delina Fico, (Administrata Publike, Shqipëri)
 Marte Prenkpalaj, (Motrat Qiriazit)
 Vjosa Dobruna, (Radiotelevizioni i Kosovës)

Gjatë Kuvendit Vjetor të RrGGK në dhjetor, anëtarët zgjodhën Bordin e ri të Drejtorëve për vitin 2008 (nga e majta në të djathtë, nga lart poshtë):

Nazlije Bala (UNDP - WSSI)
 Kryetare e Bordit - Belgjzare Muharremi (Dera e Hapur)
 Arjeta Rexha (Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore)
 Besim M. Kajtazi (Ministria e Shërbimeve Publike)
 Veprorë Shehu (Medica Kosova)
 Behar Selimi, (Shërbimi Policor i Kosovës)
 Marte Prenkpalaj (Motrat Qiriazit)



Punonjësit e përhershëm të RrGGK

Igballe Rogova – Drejtoreshë Ekzekutive
Aida Dërguti – Menaxhere e Programeve
Besa Shehu – Menaxhere Financiare
Alba Loxha – Menaxhere për Informim dhe Marrdhënie me Publikun

Punonjësit në projekte gjatë vitit 2007

Nicole Farnsworth – Këshilltare dhe Hulamtuese
Aida Dërguti – Koordinatore i Projektit
Besa Ahmeti – Koordinatore i Projektit
Adelina Berisha – Hulamtuese
Mimoza Gashi – Hulamtuese

Dafina Beqiri – Hulamtuese për projektin Rezoluta 1325, Koordinatore për Projektin e Kodit të Mirësjelljes të RrGGK

Linda Gusia – Këshilltare për fushatë mediale
Lynne Alice – Kryesuese e hulumtimit mbi implementimin e Rezolutës 1325
Ali Misimi – Hulamtuese në projektin për Rezolutën 1325
Albana Lumi – Hulamtuese në projektin për Rezolutën 1325
Remzije Asllani – Koordinatore i Projektit
Elizabeth Carolan – Praktikante (qershor – gusht) nga Irlanda

Raporti Vjetor i Auditit të RrGGK-së



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Kemi bërë auditimin e shpenzimit dhe të hyrat financiare Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës për vitin që është përfunduar.
Përgjegjësinë për këto pasqyra bërë menaxhmenti i Rrjetit i Grupeve të Grave të Kosovës. Përgjegjësjë e jonë është dhënia e një opinioni për këto pasqyra bazuar në auditimin tonë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Kosovare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe kryejmë një auditim për të arritur sigurinë e arsyeshme në lidhje me faktin që pasqyrat financiare janë të lira nga anomali të materiale. Një auditim përfshin ekzaminimin, mbi bazën e testimit, të evidencës që mbështet shumat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe të vlerësimeve kryesore të bëra nga menaxhmenti, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë që auditimi ynë siguron një bazë të mjaftueshme për opinionin tonë.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare pasqyrojnë drejtë pozitën financiare të OJQ "Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës" përfundimisht më 31. dhjetor 2007 si dhe rezultatin afarist dhe rrjedhën e parasë gjërë në përfundim të vitit dhe është në harmoni me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Data
18.04.2008
Prishtinë

Xhemail Sylja Auditor i Licencuar

Sylë Hotla I

XHEMAIL SYLA
Auditor i Licencuar
Licensed Auditor

Raporti Financiar 2007 i RrGGK-së

Donatorët	Projektet	Mbetjet nga v.2006	Të pranuar	Shpenzimet	Mbetja
1 RBF	Ndërtimi i Kapaciteteve të RrGGK	1,637.37	22,276.68	22,664.68	1,249.37
2 BTD	Qeverisja e mirë përmes edukimit të votuesve		14,717.79	8,330.80	6,386.99
3 KTK	Fuqizimi i kapaciteteve të RrGGK për avokim		28,593.00	27,610.00	983.00
4 MAMA CASH	Shfaqje teatrale "Çdo të Hënë"		11,900.00	11,900.00	0.00
5 OSCE	Pse të votohet?		25,780.00	25,139.22	640.78
6 OSCE	Fushatë Edukimi për Votuesit në zonat rurale		3,300.00	3,300.00	0.00
7 SDC	Rrjetëzimi dhe Avokimi		8,400	8,400.00	0.00
8 UNDEF (2007-2008)	Rrjetëzimi i Grave për Paqe dhe Stabilitet Rajonal		137,609.80	102,049.21	35,560.59
9 UNFPA	Mbrojtja e Shëndetit & Lufta kundër Dhunës		108,981.32	89,960.64	19,020.68
10 UNIFEM	Takimi në Vjenë i Lobit Rajonal të Grave		8,200.00	8,200.00	0.00
11 UNIFEM (2007-2008)	Fuqizimi i Grave në Vendimmarrje dhe Edukimi i Votuesve për Qeverisje të Mirë		9,600.00	6,000.00	3,600.00
12 Urgent Action Fund	Manifestimi Publik i Qytetarëve		3,600.00	3,430.00	170.00
Totali		1,637.37	382,958.59	316,984.55	67,611.41

Përkrahësit Financiar të RrGGK-së

Gjatë vitit 2007, programet dhe aktivitetet e RrGGK-së morën përkrahje nga:

Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD)
 Fondacioni Kvinna till Kvinna (KtK)
 Mamacash
 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)
 Fondi i Vëllezërve Rockefeller (RBF)
 Agjencia Zvicrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
 Urgent Action Fund (UAF)
 Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Demokraci (UNDEF)
 Fondi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM)
 Fondi Popullor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNFPA)

Distribuimi i Shpenzimeve

Lloji i Shpenzimit	Shuma	Përqindja
Pagat e stafit	47,573	12%
Përkrahja direkte për organizatat anëtare	112,051	29%
Programet dhe aktivitetet	155,728	41%
Shuma e mbetur për aktivitetet që vazhdojnë	67,608	18%
Totali	382,960	100%

Programet e Ardhshme

Më 28-29 mars, anëtarët e Bordit të Drejtorëve të RrGGK-së, Bordi Këshillues dhe stafi u mbledhën në Tiranë (Shqipëri) që të krijojnë planin strategjik për vitet 2008-2010. Gjatë kësaj mbledhjeje u përpilua plani strategjik për të ardhmen. RrGGK do të vazhdojë me misionin e njëjtë dhe objektiva të ngjashëm strategjik. RrGGK ka përcaktuar programet që do të kontribuojnë për secilin objektiv si dhe aktivitetet specifike për programet përkatëse.

Objektivi i parë i RrGGK-së është “Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë, efektive dhe aktive të grave dhe vajzave në zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Kosovë.” Programi i parë nën këtë objektiv është “Fuqizimi i grave në politikë dhe vendimmarrje”, i cili do të përfshijë aktivitetet vijuese: Monitorimi i mekanizmave për arritjen e barazisë gjinore / Rezoluta 1325 e KS të OKB-së; Forcimi i rolit të gruas në formimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë; dhe Mbledhje koordinuese dhe bashkëpunim me partitë politike. Programi i dytë “Fuqizimi i votuesve” do të përfshijë: Asistimin e votuesve me fushata avokimi në 10 komuna; Hapja e linjës telefonike dhe emailit për pranimin e ankesave dhe sugjerimeve për politikanët nga ana e qytetarëve; dhe Fushata mediale. Sa i përket këtyre aktivitetëve, RrGGK do të bashkëpunojë me Agjencinë për Barazi Gjinore, Grupin Joformal të Grave Deputete dhe Shërbimin Policor të Kosovës.

Objektivi i dytë i RrGGK-së është “Përmirësimi i të drejtave njerëzore të grave në të gjitha sferat e jetës në Kosovë”. Programi i parë “Përmirësimi i shëndetit të grave” do të përfshijë: Kontrollin mjekësor të grave në viset rurale në klinikën mobile të Medica Kosovës dhe përkrahja e fushatës kundër kancerit të gjirit nga Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit. Programi i dytë “Ulja e Trafikimit / Dhunës në Familje ” do të përfshijë: Përkrahje Koalicionit Kosovar kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës Seksuale; Hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit kundër dhunës në familje në koordinim me ABGJ, WSSI, UNDP; Asistimi për përgatitjen e draft- ligjit për ndalimin e Dhunës në Familje, avokimi dhe më vonë monitorimi i këtij Ligji në koordinim me Agjensinë për Barazi Gjinore dhe Grupin Joformal të Grave Deputete.

Sipas objektivit të tretë “Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së grupeve dhe organizatave të grave në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare si dhe në angazhimet avokuese gjegjëse”, programi “Rritja e përfshirjes së Grave në Ndërtimin e Paqes në Rajon” do të përfshijë: mbledhje, avokim, konferencë vjetore, përfshirja në proceset tranzicionale të drejtësisë dhe vetëdijësimi si pjesë e Koalicionit të Grave për Paqe; Rrjetëzimi rajonal / posaqërisht

bashkëpunimi me organizatat e grave të Maqedonisë; Vizita komunitetit serb në Kosovë. Programi “Fuqizimi i kapaciteteve të Rrjetit” do të përfshijë: vazhdimin e publikimit të Buletinit tremujor “Zëri i Grave Kosovare” dhe raportet vjetore; Monitorimin e implementimit të Kodit mbi Etikën dhe Përgjegjësitë; organizimi i takimit me donatorët me qëllim që atyre t’i prezantohen fushat e veprimtarisë të organizatave anëtare gjatë përmbushjes së Kodit; përkthimi i ueb faqes së RrGGK-së (në 3 gjuhë) dhe paraqitja në web faqe e profileve të organizatave; Ofrimi i shërbimeve për anëtarët sic janë përkrahja në ngritjen e fondeve, përkthime dhe trajnime.

Anëtaret e RrGGK-së

Ajo

Maria Kurti
044 286 319
ugafrodita@hotmail.com
Ferizaj

Alma

Shemsije Seferi
044 257 443
shemsijeseferi@hotmail.com
Sverkë, Pejë

Antigona

Rabe Rrustemi
044 192 232
r_rrustemi@hotmail.com
Skenderaj

Asebe

Esmë Karanezi
044 128 126
asebe_prizrenlule@hotmail.com
Prizren

Ato

Fikrije Ferizi
044 332 558
qendraeguas_ato@hotmail.com
Vushtri

Bardha

Raza Sadrija
044 104 126
Prishtinë

Briga

Miroslavka Simonovic
063 7210 616
miroslavkabriga@yahoo.com
Gorazdevac

Centari Romani Gjuvlenge

Emsale Mergjollari
044 274 671
emsalemergjollari@hotmail.com
Prizren

Dera e Hapur

Belxhyzare Muharremi
044 124 423
betimuharremi@hotmail.com
Prishtinë

Diana

Silvana Vokshi
044 769 778
Gjakovë

Dora Dorës

Vjosa Curri
044 216 616
dora_dores@yahoo.com
Prishtinë

Dora e Ngrohtë

Drita Rama
044 264 102
drita.g.rama@gmail.com
Rahovec

Drita

Fexhrie Mavriqi
044 350 823
febimav@yahoo.com
Prishtinë

Dua

Ilirjana Kryeziu
044 309 439
ojq_dua@yahoo.com
Prizren

Edona

Hafize Hajdini
044 657 920
ngoedona@yahoo.com
Ferizaj

Elena Gjika

Lale Grabanica
044 199 167
grabanica@hotmail.com
Klinë

Familja dhe Shpresa

Atifete Bytyqi
044 329 196
atifetebytyqi@hotmail.com
Klinë

Femra në Veprim

Kadrije Piliqi
044 227 820
kpiliqi@yahoo.com
Kaçanik

Flaka

Shehindere Dedushi
044 195 940
delidedushi@hotmail.com
Lipjan

Foleja

Gjyzel Shaljani
044 219 612
gjyzelshaljani@gmail.com
Prizren

Fortesa

Sanije Jahiri
044 643 665
sanije200@hotmail.com
Kamenicë

Gruaja Familjare

Nadire Kryeziu
044 217 223
gruaja_familjare@hotmail.com
Prizren

Gruaja për Gruan

Shemsije Xhaferi
044 155 286
xhaferi_shemsije@hotmail.com
Rahovec

Grupi i Veteranëve të Arsimit

Naxhije Buçinca
044 233 633
naxhi_gva@yahoo.com
Prishtinë

Hadër

Resmije Krasniqi
044 278 538
haderprizren@hotmail.com
Prizren

Handikos

Drita Vukshinaj
044 263 636
handikos_pz@hotmail.com
Prizren

Handikos

Mehreme Llumnica
044 198 688
mehremellumnica@hotmail.com
Prishtinë

Hanëmeli

Lirije Gash
044 343 709
liriyegas@hotmail.com
Prishtinë

Hareja

Sahadete Dula
044 204 321
shpg.hareja@hotmail.com
Prizren

Idemo Pravo

Zhivadinka Radosavlevic
064 447 0 967
Plemetin

Institute of Psychology

Myrvete Bajrami
044 209 017
mbajrami@gmail.com
Prishtinë

Jeta

Safete Gacaferri
044 253 412
ojqjeta@yahoo.com
Deçan

Jeta Ime

Shqipe Bejtullahu
044 188 336
mylife_center@yahoo.com
Gjakovë

Jeto Jetën

Xhynaze Bytyqi
044 187 021
jetojeten@hotmail.com
Prizren

Kalabria

Sevdie Bunjaku
044 234 190
kalabria24@hotmail.com
Prishtinë

Kevser

Igballe Berisha - Huduti
044 142 038
kewther_pz@yahoo.com
Prizren

Komiteti i Grave të Verbëra

Bajramshahe Jetullahu
044 185 298
kgvk_b@hotmail.com
Prishtinë

Koraci Buducnosti

Smiljana Veselinovic
038 64 202
Gracanica

Kreativa

Klara Baraku – Idrizi
044 145 744
shoqata_kreativa@hotmail.com
Prishtinë

Legjenda

Melihate Osmani
044 194 045
meliosmani@yahoo.com
Viti

Lepsa Buducnost

Radosava Mirkovic
064 533 7885
lepsi.buducnost@yahoo.com
Priluzje

Liria

Nazife Jonuzi
044 125 729
liriagjilan@hotmail.com
Gjilan

Liria

Luljeta Kuqi
044 186 824
luljeta_kuqi@hotmail.com
Suharekë

Lulebora

Selvete Gashi
044 110 970
ojqlulebora@yahoo.com
Prishtinë

Lulishtja

Sadije Dulahu
044 114 294
sadedulahu@hotmail.com
Dabishevc

Luna

Stanica Kovacevic
028 467 335
Fushë Kosovë

Mental Disability Rights

International

Zamira Hyseni
044 176 287
zhyseni@mdri.org
Prishtinë

Medica Kosova

Veprora Shehu
044 188 316
medicam_kosova@yahoo.com
Gjakovë

Motrat Qiriaz

Marte Prenkpalaj
044 113 258
motratqiriazhas@yahoo.com
Has / Prizren

Nardi

Violeta Shehu
044 450 184
nardi_99@hotmail.com
Prishtinë

Ne Jemi Pjesë e Botës

Atifete Demaj
044 239 814
njpb05@hotmail.com
Fushë Kosovë

Norma

Valbona Salihu
044 126 428
shoqatanorma@yahoo.com
Prishtinë

Oda

Violeta Selimi
044 318 982
vselimi.oda@gmail.com
Prishtinë

OGPK

Rudina Gerdec - Llapashtica
044 308 758
aibi@hotmail.com
Prishtinë

One to One Kosova

Merita Halitaj
044 172 644
qkgff_kosova@hotmail.com
Prizren / Pejë

OPER

Nurije Ferati - Haziri
044 257 316
nurije.ngo.oper@hotmail.com
Prishtinë

Promocom

Blerta Nezaj
044 145 554
ngo_promocom@yahoo.com
Gjakovë

Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit Jeta/Vita

Nafije Latifi
044 145 530
jeta.vita@yahoo.com
Prishtinë

**Qendra Kosovare për
Rehabilitimin e të Mbijetuarve
të Torturës**

Feride Rushtini
044 501 904
krct_org@yahoo.com
Prishtinë

**Qendra Kosovare për Studime
Gjinore**

Luljeta Vuniqi
044 116 898
qksgj_kgsc@yahoo.com
Prishtinë

**Qendra për Mbrojtjen e Grave
dhe Fëmijëve**

Naime Sherifi
044 508 081
cpwcprishtina@yahoo.com
Prishtinë

**Qendra për Mbrojtjen e
Viktimave dhe Parandalimin e
Trafikimit me Qenie Njerëzore**

Hamijet Dedolli
044 167 395
hamijet_dedolli@yahoo.com
Prishtinë

Qendra për Mirëqenien e Gruas

Lumnije Deçani
044 111 678
pejawwc@yahoo.com
Pejë

**Qendra për Strehimin e Grave
dhe Fëmijëve**

Nora Hoxha
044 126 568
qsgf_pz@hotmail.com
Prizren

**Qendra për Trajnime dhe
Studime Gjinore**

Arjeta Rexha
044 124 612
qtsgj@yahoo.com
Prishtinë

Qendra Resurse e OJQ-ve

Esmë Smajli
029 631 357
ngoprizren@yahoo.com
Prizren

Romane Romnja

Shpresa Agushi
044 211 905
agushishpresa@yahoo.com
Gjilan

Ruka + Ruci

Nevenka Rikallo
044 839 986
rikalonevenka@yahoo.com
Fushë Kosovë

Sara

Dashurie Sahiti
044 373 036
dashurijesahiti@yahoo.com
Dragash

SHE - ERA

Mirlinda Kusari
044 122 696
wsheera@gmail.com
Gjakovë

Shoqata e Amviseve të Kosovës

Gjylfidane Morina
044 394 226
danemorina@yahoo.com
Prishtinë

**Shoqata Këshilluese Edukative
"Ujesa"**

Shukrije Bytyqi
044 382 331
shke_ujesa@yahoo.com
Malishevë

**Shoqata për Edukimin dhe
Përkujdesjen e Familjes**

Bahrije Deva
044 152 051
shepfgjakova@yahoo.com
Gjakovë

Shpresa

Sabrije Kukaj
044 170 652
sabrijekukaj@hotmail.com
Drenas

Shpresa & Shtëpitë e Fëmijëve

Valbona Çitaku
044 200 353
vqitaku@yahoo.com
Prishtinë

Vita - Jeta

Ajshe Nuhiu
044 277 421
shjjpgvitajeta@yahoo.com
Prishtinë

Zana

Tahire Gashi
044 406 812
shg_zana@hotmail.com
Klinë

Shtëpia e Sigurtë

Sakibe Doli - Dobruna
044 161 857
linjajuaj@yahoo.com
Gjakovë

Shtjefën Gjeçovi

Shpresa Siqeca
044 350 023
shpresasiqeca808@yahoo.com
Prizren

Sibora

Hyrmete Celina
044 247 240
sibora_pz@yahoo.com
Prizren

Teuta

Nexhmije Bytyqi
044 216 623
nexhmijeb@yahoo.com
Prizren

Violete

Bedrije Shala
044 317 541
ojqviolete@hotmail.com
Barilevë / Prishtinë

Shkruar dhe dizajnuar nga
ALBA LOXHA dhe NICOLE FARNSWORTH

Fotografitë: © RrGGK

Financuar nga MOTT Foundation